



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2023, pas shqyrtimit dhe përfundimit / konkluzionit për pikën 3 të rendit të ditës, mori këtë,

### VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC

#### Neni 1

Ngritet Komisioni ad-hoc nga përbërja e Kuvendit të Komunës, për shikimin, analizimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të të dëmtuarve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 sipas rekomandimit nr.prot.02-016/01-0086038/23 datë 06.12.2023 dhe Listës përkatëse të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në përbërje si vijon;

- Ekrem Rrahmani
- Ragip Fetahu
- Bashkim Syla
- Burim Hasani
- Edona Shabani

#### Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi i qaset shikimit, analizimit dhe vlerësimin të dokumentacioneve të fermerëve dhe të tjerëve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 që nuk janë kompensuar nga ana e nivelit qendrorë por që janë kthyer në Komunë për vendosje dhe kompensim.

#### Neni 3

Për punën e bërë Komisioni përgatitë raport në formë të shkruar me rekomandime konkrete për hapat dhe veprimet e mëtejshëm që duhet të ndërmerret Kuvendi i Komunës lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve për të dëmtuarit sipas Listës përkatësisht rekomandimit të datës 06.12.2023.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës

Nr.Prot. 01-020/04-0000047/24  
Podujevë, datë: 28 dhjetor 2023

